

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NË SHQIPËRI KRAHASUAR ME STANDARTET NDËRKOMBËTARE

Femi SUFAJ*

Abstrakt: Studimi analizon në mënyrë të përmbledhur evoluimin e sistemit të drejtësisë për të mitur në Shqipëri përgjatë shekullit XX dhe periudhës aktuale, duke marrë në shqyrtim politikën, praktikën dhe kuadrin ligjor. Ai analizon arritjet dhe problemet e sistemit në kuadër të zbatimit të strategjisë kombëtare për fëmijët në qasje me konventat, udhëzimet dhe rekomandimet ndërkombëtare. Në studim shqyrtohet përmes fakteve dhe shifrave situata e dënimeve të të miturve në Shqipëri, shkalla e recidivizmit, përbërja sociale, niveli arsimor dhe kulturor dhe faktorët ndikues në kriminalitetin e të miturve. Një vend i kushtohet edhe ndikimit të shoqërisë civile në reformimin e sistemit të drejtësisë për të mitur. Në fund studimi mbyllet me disa rekomandime të rëndësishme për përmirësimin e drejtësisë për të mitur, si përkthimi zyrtar dhe shpërndarja e të gjitha konventave, udhëzimeve dhe rekomandimeve për të miturit. Krijimi i një kuadri ligjor specifik të drejtësisë për të mitur në Shqipëri, aplikimin e diskrecionit dhe masave dhe sanksioneve alternative si dhe zbatimin e programeve konkrete parandaluese dhe riintegruese.

Fjalët kyçe: Drejtësia për të mitur, standartet, reformim, riintegrim, parandalim.

1. Hyrje

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve përbën një nga drejtimit më të rëndësishme të politikave shoqërore në Republikën e Shqipërisë.¹ Në themel të këtyre politikave janë parimet themelore të Kushtetutës, të Konventave të OKB-së dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar, të cilat theksojnë se fëmijët, për shkak të veçorive të moshës, të mungesës së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për një mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore. Një vëmendje e veçantë në këtë kuadër është treguar ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin duke përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme sistemin e drejtësisë për të miturit në përputhje me standartet ndërkombëtare.

2. Një vështrim i shkurtër historik i legjislacionit kriminal mbi të miturit

Në periudhën deri në fundin e vitit 1944, kur në Shqipëri u vendos qeveria komuniste, legjislacioni penal në përgjithësi ishte i orientuar drejt vendeve të cilat kishin ndikim mbi vendin tonë. Konkretisht deri në vitet 20, kanë qenë në zbatim ligjet penale të Turqisë,

* Femi SUFAJ, Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve Shqipëri.

¹ Nenet 54 dhe 59 të Kushtetutës shqiptare parashikojnë mbrojtje dhe përkrahje të veçantë nga shteti për fëmijët.

për vetë rrethanat historike të kohës, ku vendi ynë ishte qenë pjesë e Perandorisë Osmane deri në vitin 1912. Me shpalljen e Shqipërisë republikë në vitin 1925 me president Ahmet Zogun dhe në vitin 1928 monarki, legjislacioni penal u orientua drejt vendeve të Europës Perëndimore. Në Kodin Penal të Mbretërisë Shqiptare të vitit 1928, ndjekja penale parashikohej mbi moshën 10 vjeç, por në qoftë se faji i kryer dënohej me vdekje, burgim të përjetshëm, burgim të rëndë ose me burgim jo më pak se një vit, gjykata me kërkesën e prokurorit mund të urdhëronte vendosjen e fajtorit në një institut edukimi dhe përmirësimi në se ekzistonin të tilla. Në rregulloren e burgjeve të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në 18 shtator 1933, parashikohej mbajtja e të rinjve deri në moshën 21 vjeç në dhoma të ndara nga të rriturit si dhe vendosja e tyre në burgjet e prefekturave edhe në se ishin dënuar më pak se një vit. Po kështu parashikoheshin përparësi në arsimimin dhe trajtimin e tyre.

Në periudhën 1945-1990 legjislacioni penal në tërësi orientohet drejt vendeve të sistemit komunist, dhe kryesisht drejt ish Bashkimit Sovjetik. Kjo deklarohet qartazi nga ish udhëheqës të qeverisë komuniste që e konsideronin si “i vetmi model i drejtë i zhvillimit dhe qeverisjes”. Në K.P të vitit 1952 (ribotim 1959) në nenin 6 parashikohej përgjegjësia penale. “Ka përgjegjësi penale personi, i cili, kur ka kryer krimin, ka mbushur moshën 14 vjeç. Kundër personit që, përshkak të moshës nuk ka përgjegjësi penale, mund të merren masa edukonjëse”. Në masat edukonjëse parashikohej si vijon:

a) Dorëzimi i të miturit në kujdestarinë e prindërve, të adaptuesve, të kujdestarëve, të të afërmeve, në qoftë se këta kanë mundësi ta mbajnë, ose nën kujdesin e personave të tjerë ose të institucioneve.

b) Mbyllja në një institucion të posaçëm edukimi dhe mjekimi. Kodi Penal parashikonte rastet e përjashtimit të të miturve nga dënimi penal dhe ndalonte dënimin me vdekje për personat nën 18 vjeç.

Këto dispozita janë ruajtur të njëjta edhe në Kodin Penal të vitit 1977, i cili është miratuar pas Kushtetutës së vitit 1976, por ka disa ndryshime të vogla të cilat pasqyrojnë situatën politike dhe ideologjike në të cilën ndodhej sistemi. Kështu tek masat edukuese që mund të zbatoheshin ndaj të miturve parashikohej:

a) Vendosja e të miturit në një institucion edukimi; dhe

b) Lënja e personit për edukim kolektivit dhe organizatave shoqërore

Nga viti 1957 deri në vitin 1969, në Shqipëri ka funksionuar një qendër për të miturit e cila emërtohej “Kolonja e edukimit”. Tabela e mëposhtme na lejon të krijojmë një ide mbi kapacitetin, përbërjen e fëmijëve, si dhe statusin ligjor të tyre.

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NË SHQIPËRI

Statistikë mbi gjendjen e fëmijëve të mbyllur në Koloninë e edukimit nga viti 1957-1969

Fëmijë gjithsej	Janë liruar	Nga fshati	Nga qyteti	Me prindër	Pa prindër
582	485	551	31	569	13

Fëmijë gjithsej	Janë të moshës deri ne 14 vjeç	15-16 vjeç	Mbi 16 vjeç	Liruar si të edukuar	Liruar si të sëmurë mendor	Liruar për arsye të tjera
582	326	211	45	569	13	29

Koha e qëndrimit në koloni

Deri 1 vit	Deri 2 vjet	Deri 3 vjet	Deri 4 vjet	Deri 5 vjet	Deri 6 vjet	Deri 7 vjet
73	117	137	83	39	11	5

Janë marrë në përgjegjësi penale pas daljes nga kolonia.

Për vjedhje	Sjellje e padenjë	Rrahje e plagosje	Krime kundër shtetit	Krime të tjera	Rikthyer në koloni
66	5	4	8	8	25

Kolonia e edukimit u mbyll në vitin 1969, me motive ideologjike, në vazhdimësi të masave që ishin marrë në kuadër të revolucionarizimit dhe të thellimit të vijës së masave. Kujtojmë këtu disa masa të tjera si mbyllja e Ministrisë së Drejtësisë, heqja e avokatisë etj. Por nga të dhënat dhe nga analizat e bëra, argumentohet se kolonia ishte një institucion i dështuar dhe u vendos lënia e të miturve që janë shkelës të ligjit në gjirin e organizatave shoqërore për edukim. Kjo vërtetohet edhe nga numri i madh i të rinjve, përsëritës në krime.

Në dhjetor 1986 u hap shkolla e riedukimit të të miturve.² Në këtë institucion do të vendoseshin të mitur të moshës 14-18 vjeç, të cilët kishin marrë dënime nga gjykatat dhe të tjerë nën moshën 14 vjeç të cilët vendoseshin në shkollë me vendim të komisionit të ndjekjes së krimeve pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme. Në bazë të programit të shkollës ishte arsimimi i detyruar dhe profesional i të miturve dhe organizimi i tyre në punë të ndryshme sidomos në bujqësi. Shkolla e Riedukimit u mbyll në vitin 1991.

² Me dekret nr. 7003 datë 28.10.1985 të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe VKM nr. 438 datë 20.12.1986.

3. Drejtimit kryesore të reformave pas rënies së sistemit komunist.

Një periudhë e re ka nisur në reformimin e sistemit të drejtësisë për të miturit pas rënies së sistemit komunist. Dy janë momentet më të rëndësishme të cilat përbëjnë pikënisjen e reformave të drejtësisë për të miturit, miratimi i dispozitave kushtetuese dhe i paketës mbi liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve dhe ratifikimi i Konventës së OKB mbi të Drejtat e Fëmijës më 27 shkurt 1992. Drejtimit kryesore të reformave kanë qenë, krijimi i kornizës ligjore dhe praktikave procedurale në përputhje me standartet ndërkombëtare, përmirësimi i infrastrukturës për ekzekutimin e vendimeve penale dhe trajnimi i profesionistëve që lidhen me sistemin e drejtësisë për të mitur. Miratimi i Kodit Penal dhe Procedural në vitin 1995, shënon një hap tepër të rëndësishëm në reformimin e sistemit të drejtësisë penale. Kodet janë hartuar me asistencën e Komisionit Europian, dhe janë në përputhje me konventat ndërkombëtare të ratifikuara, rekomandimet dhe udhëzimet dhe pasqyrojnë eksperiencat më të mira europiane. Në Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale (KPP), gjejnë pasqyrim të plotë të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me fëmijët në konflikt me ligjin. Pas miratimit të Kushtetutës në vitin 1998, janë miratuar disa ligje të rëndësishme, të cilat kanë kompletuar kornizën ligjore të sistemit të drejtësisë për të mitur, si Ligji nr 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, Ligji nr 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, Ligji nr 8677 datë 02.11.2000 “Për policinë gjyqësore”, Ligji nr 8678 datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, Ligjet për policinë e shtetit, për policinë e burgjeve, për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë e me radhë. Gjithashtu janë miratuar një sërë aktesh nënligjore të rëndësishme, ku do të përmendim Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve, Vendimin e Qeverisë për kalimin e sistemit të paraburgimit nën administrimin e Ministrisë së Drejtësisë etj.

Referuar të dhënave zyrtare të INSTAT-it për vitin 2006, numri i përgjithshëm i fëmijëve në Shqipëri është 1.396.000 nga 3.320.000 banorë gjithsej, duke përfaqësuar rreth 40% të popullsisë. Kujdesi për fëmijët ka zënë një vend të rëndësishëm në politikat shtetërore të qeverisë shqiptare. Kështu është miratuar Strategjia për Fëmijët dhe Plani i Veprimit për periudhën 2001-2005 dhe 2005-2010. Strategjia Kombëtare për Rininë 2007-2013, Strategjia Kombëtare dhe Plani i Punës për luftën kundër Trafikut të Fëmijëve dhe mbrojtjes së Fëmijëve viktime të trafikut. Nga hapat që janë bërë në përmirësimin e sistemit të drejtësisë për të miturit, përveç infrastrukturës ligjore, do të përmendim krijimin e seksioneve të gjykatave për të mitur në gjashtë rrethe gjyqësore, ku janë vendosur edhe gjykatat e apelit; kalimin e sistemit të paraburgimit nën përgjegjësinë dhe administrimin e Ministrisë së Drejtësisë që nga viti 2007; ndërtimin e një institucioni modern për të miturit në Kavajë, i cili i plotëson të gjithë parametrat e sigurisë dhe të riintegritetit të të miturve; ndërtimin e pesë institucioneve të reja për ekzekutimin e vendimeve penale sipas standarteve ndërkombëtare; krijimin e seksioneve për të miturit

në prokuroritë e rretheve gjyqësore, të policisë së shtetit dhe trajnimi i vazhdueshëm i punonjësve të institucioneve të të miturve. Ngritja e shërbimit të Provës ka mundësuar zbatimin e dënimeve alternative duke shmangur dënimin me burg dhe arrestimin në burg. Nëqoftë se në vitin 2008 janë dënuar me burg 361 të mitur, në vitin 2010 kanë kaluar në shërbimin e provës 150 të mitur dhe në arrest me burgim 101 të paraburgosur dhe 20 të dënuar.³

4. Standartet ndërkombëtare mbi drejtësinë për të mitur

Aktet ndërkombëtare në lidhje me drejtësinë për të miturit, klasifikohen në instrumenta të Kombeve të Bashkuara, të Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian. Në instrumentat e Kombeve të Bashkuara renditen:

- a) Konventa e OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (1989) ratifikuar më 27 shkurt 1992 dhe Protokollit shtesë i saj, datë 18 janar 2002, lidhur me Shitjen, Prostitucionin dhe Pornografinë e fëmijëve;
- b) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e vitit 1948;
- c) Deklarata mbi të Drejtat e Fëmijës;
- d) Rregullat Standart Minimum të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit 1985);
- e) Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve që u është Hequr Liria (Rregullat e Havanës 1990);
- f) Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Riadit);
- g) Rregullat Standart Minimum lidhur me Masat e Mosarrestimit, (rregullat e Tokios);
- h) Pakti Ndërkombëtar lidhur me të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966;
- i) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit apo Ndëshkimit Mizer, Çnjerëzor dhe Degradues.

Në instrumentet e Këshillit të Evropës si më të rëndësishme në këtë drejtim do të rendisnim:

- a) Konventën Europiane të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe Protokollet nr. 1, 2, 4, 5, 6, 7, 11;
- b) Karta Sociale Europiane e Rishikuar;
- c) Konventa Europiane mbi Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve;
- d) Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës, dhe Dënimeve dhe Trajtimeve Çnjerëzore apo Degraduese dhe protokollit nr 1 dhe 2;
- e) Konventa Europiane mbi të Drejtat Sociale;

³ Të dhënat e muajit maj 2010.

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NË SHQIPËRI

- f) Konventa Europiane për Mbikqyrjen e Personave të Dënuar ose të Liruar me Kusht (ratifikuar me Ligjin nr 8724 datë 26.12.2000).

Ndër rekomandimet dhe rezolutat e Këshillit të Evropës për drejtësinë për të miturit mund të veçohen:

- a) Rezoluta (78)62 ‘Mbi delikuencën e të miturve dhe ndryshimet sociale’;
- b) Rekomandimi (85)7 ‘Mbi pjesëmarrjen e publikut në politikën penale’;
- c) Rekomandimi (85)4 ‘Për dhunën në familje’;
- d) Rekomandimi (87)19 ‘Mbi parandalimin e krimit të organizuar’;
- e) Rekomandimi (87)20 ‘Mbi reagimin social ndaj delikuencës së të miturve’;
- f) Rekomandimi (87)21 ‘Për asistencën ndaj viktimave të krimit dhe parandalimin e viktimizimit’;
- g) Rekomandimi (91)11 ‘Mbi shfrytëzimin seksual, pornografinë, prostitucionin dhe trafikimin e të rinjve dhe të fëmijëve’;
- h) Rekomandimin e Këshillit të Evropës ‘Për ndërhyrjen e herëshme psiko-sociale në parandalimin e kriminalitetit’;
- i) Rekomandimi (2006)2 ‘Rregullat Europiane të Burgjeve’;
- j) Rekomandimi (2008)11 ‘Rregullat mbi shkelësit e mitur subjekt të sanksioneve dhe masave’;
- k) Udhëzuesi i Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore për fëmijët, qershor 2010.

Procesi i integritit është një rrugë e cila imponon detyrimisht përmbushjen e standarteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtësisë për të miturit. Megjithëse instrumentat e BE janë të lidhur vetëm me shtetet anëtare, vendet jo anëtare siç është vendi ynë, që kërkon të antarësohet në BE, duhet të harmonizojnë legjislacionin me standartet e BE.

Nga aktet e mësipërme ndërkombëtare do të veçojmë KDF, e cila është një akt me karakter të fortë detyrues, zbatimi i së cilës mbikqyret nga një organ i krijuar nga vetë konventa që është Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijëve. Çështjet që lidhen me drejtësinë për të mitur përfshihen në nenet 37, 39 dhe 40 të KDF, por këto nuk mund të merren të shkëputura nga gjithë konteksi i konventës, pasi të gjitha dispozitat e saj janë të varura nga njëra-tjetra dhe formojnë një të tërë. Neni 40 duhet parë i lidhur me parimet e përgjithshme të parashtruara lidhur me fëmijët, përkatësisht me nenin 2 të KDF ku nënvizohet parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, nenin 3(1) mbi interesin më të lartë të fëmijës si konsiderata më e lartë; nenin 6 mbi të drejtën e jetës, nenin 12 mbi respektimin e të drejtës për të shprehur lirisht pikëpamjet, dhe duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë. E drejta e fëmijës që të dëgjohet në çdo procedurë

gjqësore ose administrative, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar. Të lidhur ngushtë me zbatimin e nenit 40 të KDF janë neni 16 mbi të drejtën e privatësisë; neni 19 mbi mbrojtjen nga çdo lloj dhune; neni 20 mbi përkujdesin alternativ; neni 25 mbi rishikimin periodik të trajtimit; neni 39 mbi përkujdesjen për rehabilitimin e viktimave. Sa më sipër dhe të tjera, japin formatin e disa standarteve kryesore lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Neni 37 i KDF ka në përmbajtjen e vet, ndalimin e torturës, dhe të trajtimit mizor, degradues, dhe çnjerëzor. Arrestimi, ndalimi ose burgimi duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe të përdoren si masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër. Çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore, duhet të jetë i veçuar nga të rriturit dhe duhet të jetë gjithnjë në kontakt me familjen e tij. Fëmijët e privuar nga liria kanë të drejtë për asistencë juridike dhe të drejtë për të kundërshtuar privimin e lirisë dhe marrjen e një vendimi sa më të shpejtë në lidhje me çështjen.

Neni 40 i KDF përcakton një listë me minimumin e garancive që duhet të jenë të vlefshme për një fëmijë që akuzohet për një vepër penale. Disa reflektojnë parimet e parashikuara më parë për çdo person, përfshirë edhe fëmijët, në instrumenta të tjera ndërkombëtare, por disa janë të aplikueshme posaçërisht për fëmijët. Rregullat e Pekinit parashikojnë që garancitë themelore procedurale si prezumimi i pafajësisë, e drejta për t'u informuar në lidhje me akuzën, e drejta për të mos folur, e drejta për t'u këshilluar, e drejta për të patur të pranishëm një prind ose kujdestar ligjor, e drejta për të pyetur dëshmitarët dhe e drejta për të apeluar vendimin në një shkallë më të lartë, duhet të garantohen në të gjitha shkallët e procedimit. Të gjitha këto janë çështje me rëndësi që përfaqësojnë elementë thelbësorë për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe që janë të njohura botërisht në instrumentat ekzistuese të të drejtave të njeriut. Procedurat duhet të drejtohen nga interesi më i lartë i të miturit dhe duhet të kryhen në një atmosferë mirëkuptimi e cila do të lejojë të miturin të marrë pjesë dhe të shprehet lirisht.

Prezumimi i pafajësisë reflekton nenin 11 të Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut, dhe nenin 14(2) të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Raste të zbatimit të procedurave duke bërë presion mbi fëmijët, duke iu drejtuar pyetje provokuese dhe sugjestionuese, të shoqëruara herë-herë me presion psikologjik apo fizik si dhe një trajtim në institucionet penale në mënyrë të ndryshme nga të dënuarit, bie ndesh me standartin e prezumimit të pafajësisë. *E drejta e informimit për akuzat e ngritura kundër tij*, në se është e përshtatshme, me anë të prindërve të tij ose të përfaqësuesve ligjorë, dhe të ketë ndihmën juridike ose çdo ndihmë tjetër për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij është një e drejtë tjetër e rëndësishme. Neni 9(2) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike kërkon që çdokush që arrestohet të informohet menjëherë për çdo akuzë që drejtohet ndaj tij. Konventa shton edhe kërkesën për të

informuar të miturin “në se është e përshtatëshme, nëpërmjet prindit ose kujdestarit ligjor” dhe kjo kërkesë shtohet në aspektin e mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës. Një e drejtë tjetër e rëndësishme është *shqyrtimi pa vonesë i çështjes* kundër të miturit nga një autoritet ose instancë gjyqësore kompetente, e pavarur dhe e paanshme, sipas një procedure të drejtë ligjore, në praninë e ndihmës juridike ose të një ndihme tjetër të përshtatshme dhe kur gjykohet se kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, sidomos për arsye të moshës ose gjendjes së tij, në prani të prindërve ose të përfaqësuesve të tij ligjor. Dispozita të tilla të ngjashme ekzistojnë në Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut dhe në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Konventa kërkon një gjykim pa vonesë të tepruar në rastin e fëmijëve. Neni 40 nuk i referohet paraburgimit, sepse neni 37 kërkon që kufizimi i lirisë në çdo rast duhet të përdoret si një masë ekstreme dhe për një periudhë sa më të shkurtër të mundshme.

Një tjetër garanci është edhe mosdetyrimi për të dëshmuar ose pohuar fajësinë, për të pyetur ose të bëjë të pyeten dëshmitarët e akuzës dhe për të siguruar paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij, në kushte të barabarta. Sipas nenit 11 të Deklaratës së të Drejtave të Njeriut dhe nenit 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike në përcaktimin e akuzës penale, çdo person duhet të ketë të drejtën të mos detyrohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose të pranojë fajësinë. E drejta për ankim është parashikuar në nenin 14(5) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, i cili parashikon që çdo person i dënuar për një krim duhet të ketë të drejtën e rishikimit të vendimit dhe dënimit të tij nga një gjykatë më e lartë sipas ligjit.

Po ashtu gjatë procesit penal një i mitur ka të drejtë të ndihmohet falas nga një përkthyes, nëqoftë se ai nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën që përdoret. Kjo e drejtë garantohet nga neni 14(3) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe është e rëndësishme jo vetëm në rastin e një fëmije që flet një gjuhë tjetër, por edhe për një fëmijë me aftësi të kufizuara.

Një garanci tjetër me shumë rëndësi është respektimi i jetës private të fëmijës në të gjitha fazat e procedurës. Neni 14(1) i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike parashikon rregulla të përgjithshme në lidhje me dëgjimin publik të seancave, duke përcaktuar raste të veçanta në të cilat shtypi dhe publiku mund të mos lejohen të marrin pjesë, për shembull kur interesi i fëmijës çënohet ose në gjykimet që lidhen me mosmarrëveshjet martesore apo kujdestarinë e fëmijës. Rregullat e Pekinit e zgjerojnë përmbajtjen e kësaj të drejte duke parashikuar që e drejta e fëmijës për fshehtësi duhet të respektohet në të gjitha shkallët e gjyimit në mënyrë të tillë që të shmanget çdo dëmtim që mund ti shkaktohet fëmijës nga publiciteti i tepërm. Në parim asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e fëmijës që abuzohet nuk duhet të publikohet. Kjo dispozitë thekson rëndësinë e mbrojtjes së jetës private për të miturin. Të miturit janë veçanërisht të prekshëm ndaj stigmatizimeve.

Shtetet Anëtare duhet të bëjnë përpjekje për të promovuar nxjerrjen e ligjeve, krijimin e procedurave, autoriteteve dhe institucioneve që merren me fëmijët që hetohen, akuzohen ose që njihen si fajtorë për shkeljen e ligjit penal. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve vazhdimisht ka propozuar një sistem të ndryshëm drejtësie për të miturit. Rregullat e Pekinit theksojnë se “Përpjekje të shumta duhen bërë për të vendosur në çdo legjislacion kombëtar disa ligje, rregulla dhe dispozita të aplikueshme veçanërisht për të miturit dhe institucione të caktuara për funksionimin e administrimit të drejtësisë për të mitur, të cilët duhet:

- a) Të përmbushin nevojat e të miturit, ndërkohë që mbrojnë të drejtat e tij themelore;
- b) Të përmbushin nevojat e shoqërisë;
- c) Të zbatojnë rregullat me drejtësi dhe paanshmëri.

Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve ka hartuar disa rekomandime specifike në zbatim të nenit 40 të KDF. Komiteti ka konstatuar se në shumicën e shteteve anëtare, nuk janë caktuar gjyqtarë për të miturit dhe ka mangësi në programet e trajnimit të këtyre gjyqtarëve. Komiteti ka mirpritur përshtatjet e fundit dhe hyrjen në fuqi të kodeve të reja për të miturit të cilët përfaqësojnë një progres të rëndësishëm drejt harmonizimit të legjislacionit dhe të politikave me dispozitat e Konventës dhe sigurimin e një kuadri ligjor për zbatimin e saj.

Legjislacioni ynë është në përputhje me standartet e KDF përsa i përket përcaktimit të një moshe minimale nën të cilën fëmijët do të konsideroheshin si të papërgjegjshëm për veprimet e tyre kundër ligjit penal. Moshë e përgjegjësisë penale në Shqipëri është 14 vjeç për krime dhe 16 për kundravajtje penale. Përdorimi i masave të përshtatshme për t'i trajtuar këta fëmijë duke shmangur procedurat gjyqësore dhe duke siguruar respektin e plotë të drejtave të njeriut dhe garancive ligjore janë parashikuar në Rregullat e Pekinit, të cilat e zgjerojnë kuptimin e tyre në mbështetjen që i bëjnë shmangjes së procedimit penal në rregullin 11. Duhet të merret në konsideratë fakti që, kur kemi të bëjmë me shkelës të ligjit që janë të mitur, të bëhet e mundur shmangja e procedimit penal nga autoritetet përkatëse sipas rregullit 14(1).

Policia, prokuroria ose agjensi të tjera që kanë të bëjnë me çështjen e të miturve duhet të autorizohen të merren me këtë çështje sipas diskrecionit të tyre, pa ju drejtuar seancave formale, në përputhje me kriteret e përshkruara më poshtë të pasqyruara në legjislacionin vendës si dhe me parimet që përmbajnë këto rregulla. Çdo shmangje nga këto procedura duhet të kërkohet nga i mituri, prindi ose kujdestari ligjor dhe ky vendim duhet të merret nga autoriteti përkatës. Një sërë dispozitash si urdhrat e mbikqyrjes, kujdesjes, drejtimit, këshillimeve, lirimet me kusht, riedukimit, programet e trajtimit, edukimit dhe mësimit të profesioneve dhe alternativa të tjera të përkujdesjes nga ana e institucioneve duhet të

jenë të vlefshme për të siguruar që fëmijët të trajtohen në mënyrë të përshtatshme dhe në përpjestim me rrethanat dhe kundërvajtjen e tyre.

Rregullat Standart Minimum të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit)

Standartet minimum synojnë krijimin e një sistemi të specializuar të drejtësisë për të miturit dhe krijimin e një legjislacioni të posaçëm. Këtu theksojmë:

- Përfshirjen e të miturit nga dënimi kapital dhe prej ndëshkimeve trupore;
- Trajtimin e paanshëm dhe njerëzor;
- Mbatjen parasysh të mendimeve të të miturit;
- Burgimi të jetë mundësia e fundit dhe qëndrimi në burg të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur;
- Heqja e lirisë duhet të aplikohet në raste shumë të rënda;
- Dhënia e vendimeve sa më shpejt të jetë e mundur;
- Specializimi i organeve të drejtësisë;
- Riintegrimi i të miturit.

Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Rinjve të cilëve u është Hequr Liria (Rregullat e Havanës)

Parimet më të rëndësishme që nënvizohen në Rregullat e Havanës janë:

- Heqja e lirisë është masë e fundit dhe kjo duhet të ketë kohëzgjatje të kufizuar;
- Heqja e lirisë për të miturit nuk mund të bëhet pa një motiv juridik objektiv;
- Krijimi i institucioneve të hapura të jetë një prioritet;
- Përgatitja e të miturve të cilëve u është hequr liria për rikthimin e lirisë dhe rikthimin në komunitet, rëndësia e programeve edukuese për ta;
- Mbatja e kontakteve me familjen;
- Trajnimi i personelit të institucioneve ose të qendrave.

Udhëzimet e OKB –së për Parandalimin e Kriminalitetit të të Rinjve (Udhëzimet e Riadit)

Këto udhëzime i dedikohen parandalimit të kriminalitetit tek të miturit bazuar në këto parime themelore:

- Parandalimi i kriminalitetit të të miturve është pjesë esenciale e parandalimit të krimit në shoqëri. Të rinjtë mund të zhvillojnë qëndrime jo kriminale nëpërmjet përfshirjes në aktivitete të ligjshme e të dobishme për shoqërinë dhe nëpërmjet mbajtjes së një qëndrimi humanist ndaj shoqërisë dhe këndvështrimit mbi jetën.

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NË SHQIPËRI

- Parandalimi i sukseshëm i kriminalitetit të të miturve kërkon përpjekje nga të gjithë shoqëria, për të siguruar një zhvillim harmonik të adoloshentëve, duke respektuar dhe mbrojtur personalitetin e tyre që në fëmijërinë e hershme.

Për interpretimin e këtyre udhëzimeve, duhet ndjekur një orientim që në qendër të vendoset fëmija. Të rinjtë duhet të kenë një rol aktiv dhe partneriteti brenda shoqërisë dhe nuk duhet trajtuar thjesht si objekte shfrytëzimi dhe kontrolli. Në zbatimin e këtyre udhëzimeve, në përputhje me sistemin ligjor kombëtar, mirëqenia e të rinjve, duke filluar që nga fëmijëria e herëshme, duhet të jetë fokusi i të gjitha programeve parandaluese. Duhet të njihet dhe të vlerësohet nevoja dhe rëndësia e politikave të parandalimit progresiv të kriminalitetit dhe të studimit sistematik e përpunimit të masave të nevojshme. Këto duhet të shmangin inkriminimin dhe penalizimin e fëmijës për sjellje që nuk i shkaktojnë dëme të rëndësishme zhvillimit të tij apo të dëmtojnë të tjerët.

Rekomandimi 2008(11) parashikon ndër të tjera që:

- Shkelësit e mitur që ju nënshtrohen sanksioneve ose masave do të trajtohen duke respektuar të drejtat e tyre njerëzore;
- Sanksionet dhe masat që do të imponohen mbi të miturit si dhe mënyra e implementimit duhet të jenë të specifikuara në ligj dhe do të bazohen në parimet e integritetit social, arsimimit dhe të parandalimit të shkeljeve;
- Sanksionet dhe masat do të caktohen nga gjykata, ose një autoritet tjetër i ligjshëm dhe do t'i nënshtrohen një gjykimi të shpejtë dhe do të imponohen për periudha minimale dhe vetëm për qëllime legjitime;
- Vendosja dhe zbatimi i sanksioneve ose masave do të bazohet në interesin më të mirë të fëmijëve, duke marrë parasysh veprën e kryer, (*proporcionaliteti*), dhe duke marrë parasysh moshën e tyre, mirëqenien fizike dhe mendore, zhvillimin, kapacitetet dhe rrethanat personale (*individualizimi*), të mbështetur në raporte psikologjike, psikiatrike dhe sociale;
- Në mënyrë që të përshtaten me zbatimin e sanksioneve dhe masave në rrethana të veçanta, autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre duhet të kenë një shkallë të mjaftueshme të diskrecionit, pa çuar në pabarazi serioze të trajtimit;
- Sanksionet dhe masat nuk do të jenë të tilla që të fyejnë ose të degradojnë të miturin, subjekt i tyre;
- Sanksionet ose masat nuk do të zbatohen në mënyrë që të përkeqësojnë karakterin apo të vënë në rrezik shëndetin mendor e fizik të fëmijës;
- Sanksionet ose masat do të zbatohen pa vonesë dhe deri në masën dhe periudhën e domosdoshme (*parimi i ndërhyrjes minimale*).

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NË SHQIPËRI

- Privimi nga liria i të miturit do të jetë një masë e shkallës së fundit dhe do të imponohet dhe zbatohet për një periudhë sa më të shkurtër të jetë e mundur. Perpjekje të mëdha duhen bërë për të shmangur paraburgimin.
- Sanksionet ose masat do të caktohen dhe zbatohen pa diskriminim të asnjë lloji si për arsye gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, orientimi seksual, mendimit politik, apo ndonjë statusi tjetër (*parimi i mosdiskriminimit*).

Ndermjetsimi apo masat e tjera duhen inkurajuar ne te gjitha fazat e procesit qe kane te bejne me te miturin si shkeles i ligjit. Çdo sistem drejtesie qe ka te beje me te miturin duhet te siguroje pjesëmarrjen e tyre efektive lidhur me imponimin e masave ose sanksioneve. Te vegjelit nuk do te kene me pak te drejta se te rriturit per mbrojtje ligjore sipas Kodit te Procedures Penale. Çdo sistem drejtesie qe ka te beje me te miturit duhet te marre parasysh te drejtat dhe pergjegjesite e prinderve ose te kujdestareve ligjore dhe per aq sa eshte e mundur duhet te perfshihen ne proceduren e ekzekutimit te masave ose sanksioneve, pervec kur kjo nuk eshte ne interesin me te mire te femijes. Çdo sistem drejtesie per te miturit duhet te ndjeki nje qasje shume disiplinare dhe te integrohet me iniciativat e shumta per vazhdimesine e kujdesit per te miturit. (*Parimi i perfshirjes se komunitetit dhe i kujdesit te vazhdueshem*) E drejta e intimitetit do te respektohet plotesisht ne te gjitha fazat e procedures. Identiteti i te miturit dhe informacionet per te nuk do të publikohen.

Udhëzuesi drejt një drejtësie miqësore për fëmijët, aprovuar në qershor 2010 nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës

Udhëzuesi European synon të mbrojë dhe promovojë të drejtat e fëmijëve në lidhje me informimin, përfaqësimin dhe pjesëmarrje në procedurat administrative dhe penale në të gjitha shkallët e procedimit. Drejtësia miqësore e fëmijës i referohet sistemeve të drejtësisë që garantojnë respektimin dhe zbatimin efektiv të të gjitha të drejtave të fëmijëve në nivelin më të lartë të arritshëm duke pasur parasysh parimet e listuara më poshtë dhe duke marrë parasysh nivelin e pjekurisë dhe të kuptuarit dhe rrethanat e rastit të fëmijës. Udhëzimet janë ndërtuar mbi bazën e parimeve ekzistuese të përcaktuara në instrumentat ndërkombëtare të njohura. Parimet: Pjesëmarrja, Interesi më i mirë i fëmijës, diniteti, mbrojtja nga diskriminimi, sundimi i ligjit. Elemente te përgjithshëm të drejtësisë miqësore për të mitur:

1. Informimi dhe këshillimi
2. Mbrojtja e privatësisë
3. Siguria, (masat të veçanta parandaluese)
4. Trajnimi profesionale
5. Qasja multidisiplinar.
6. Privimi i lirisë

Vendi ynë pas viteve 90 ka ratifikuar konventat kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti. Në bazë të Kushtetutës këto instrumenta quhen pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe janë të detyrueshme për zbatim. Por nga monitorimet e disa organizatave jo qeveritare që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut ka rezultuar që niveli i njohjes dhe i zbatimit të tyre nga gjyqtarët, prokurorët, avokatët, punonjësit e policisë dhe punonjësit e sistemit të ekzekutimeve të vendimeve penale të jetë i kufizuar. Kjo sjell mos aplikimin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sistemi i drejtësisë dhe mosvenjen e tyre në shërbim të atyre që kërkojnë akses në drejtësi. Probleme ka lidhur me publikimin, përkthimin dhe vënjen në dispozicion të profesionistëve që lidhen me sistemin e drejtësisë penale. Në vitet e fundit interesi për njohjen dhe zbatimin e instrumentave ndërkombëtare ka ardhur në rritje, ato janë bërë pjesë e moduleve të trajnimit dhe është rritur monitorimi për zbatimin e tyre. Në programet e trajnimit të punonjësve të sistemit të burgjeve dhe të paraburgimit si dhe të atyre që punojnë me grupe specifike si të mitur, gra të sëmurë, të moshuar etj janë përfshirë instrumentat kryesore ndërkombëtare si dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës. Kohët e fundit është bërë e mundur botimi i përmbledhjes ligjore kombëtare dhe instrumentat kryesorë ndërkombëtar, si KDF, Rregullat e Pekinit, Rekomandim 2006(2) Rregullat Europiane të Burgjeve, dhe rekomandime të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës që është vënë në dispozicion të punonjësve të sistemit të burgjeve.

5. Legjislacioni Kombëtar dhe drejtësia për të mitur

Dispozitat ligjore lidhur me të miturit janë të shpërndara në shumë kode dhe akte nënligjore. Mungon një legjislacion ose kod gjithëpërfshirës lidhur me drejtësinë për të mitur siç parashikohet në Rregullat e Pekinit. Nuk ka një sistem ligjor të unifikuar vetëm për të mitur. Ka ligje brenda të cilëve të miturit trajtohen në mënyrë të veçantë, ka akte të tjera ku të miturit trajtohen pa dallim nga të rriturit. Deri tani nga shteti shqiptar është bërë një punë e konsiderueshme për përshtatjen e legjislacionit vendas me frymën e instrumentave ndërkombëtare, por aplikimi në praktikë mbetet çështja më e rëndësishme ku duhet vënë theksi në mënyrë të vazhdueshme.

Kushtetuta është ligji themelor në të cilin deklarohen politikat dhe vlerat më të thella të shtetit shqiptar. Sipas nenit 3 të Kushtetutës dinjiteti i njeriut dhe liritë e tij janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe mbrojë. Gjithë sistemi ligjor shqiptar është bazuar në rregullimet dhe parimet kushtetuese. Në Kushtetutën e vendit përcaktohet se çdo person, të cilit i është hequr liria ka të drejtën e trajtimit njerëzor dhe të respektimit të dinjitetit të tij. Në bazë të legjislacionit shqiptar, të pandehurit të mitur i sigurohet ndihma juridike dhe psikologjike, në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, me praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon. Gjatë fazës së gjykimit, sipas moshës së të miturit, gjykata mban parasysh

kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete. Kodi i Procedurës Penale, përcakton një sërë garancish për mbrojtjen e të miturve dhe personalitetit të tyre, konkretisht; pyetja e të miturit në seancë me dyer të mbyllura; e drejta e përfaqësuesit ligjor të të miturit për të mbrojtur interesat e tij me cilësinë e të dëmtuarit akuzues; mbrojtja e detyrueshme profesionale për të miturin nën 18 vjeç; ndalimi i publikimit të gjeneraliteteve dhe të fotografive të të pandehurve dhe të dëshmitarëve të të miturit të akuzuar ose të dëmtuar nga vepra penale; mosarrestimi për një vepër penale që përbën kundravajtje. Kodi penal ka parashikuar moshën e përgjegjësisë penale dhe dënimin e të miturit me gjysmën e masës së dënimit që mund të marrë një i rritur.

Në gjykatat e shkallës së parë me dekret nr 5351 datë 11.06.2007 të Presidentit janë krijuar seksionet e gjykatave për të mitur në gjashtë gjykata të vendit. Sipas Ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor, është parashikuar përbërja në trupin gjykues në çështjen e të miturve të një psikologu. Në ligjin nr 8645 datë 11.03.1999 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e konflikteve” është parashikuar zgjidhja e kundravajtjeve penale pa iu drejtuar procedurës gjyqësore. Ligji nuk shprehet në mënyrë të veçantë për të miturit, por i përfshin ata në kategorinë e personave që kanë kryer një kundravajtje penale pavarësisht nga mosha. Ligji për ekzekutimin e vendimeve penale dhe ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me paraburgim dhe të paraburgosurve, parashikon mbajtjen e të miturve në institucione të veçanta ose në seksione të veçanta të Institucioneve të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale. Gjithashtu parashikohen lehtësira në procedurat e vizitave, informimit, ndihmës së psikologut, aplikimit të programeve riintegruese, arsimit i detyruar etj.

6. Zbatimi në praktikë i kuadrit ligjor për të miturit

Nga studimi i të dhënave të kriminalitetit tek të miturit, konstatohet se një numër i konsiderueshëm i krimeve janë kryer nga të mitur nën 14 vjeç, për të cilët ligji parashikon papërgjegjshmëri penale. Në këtë rast dispozita ligjore parashikon aplikimin e masave me karakter edukativ, vendosjen e të miturit në një institucion edukimi. Nga eksperiencia e vendeve të tjera, rezulton të jenë krijuar institucione të mirëqenies. Aktualisht institucione të tilla në vendin tonë nuk janë krijuar. Bashkëpunimi i të gjithë aktorëve të shoqërisë civile dhe institucioneve të shtetit për parandalimin e kriminalitetit është jo në nivelin e duhur. Nga të dhënat e MASH, deri në mars 2010 rezultojnë rreth 1992 nxënës që kanë braktisur shkollën pa mbushur detyrimin ligjor. Nga një studim i bërë në Institutin e të Miturve në Kavajë, në shkurt 2010, rezulton se mosha e të miturve në këtë institucion është 16.69 vjeç. Pyetjes se cili është niveli i shkollimit, i përfunduar me dëftesë, para dënimit, i janë përgjigjur: klasën e dytë e ka përfunduar 1 fëmijë; klasën e tretë e kanë përfunduar 2; klasën e pestë e kanë përfunduar 2 fëmijë; klasën e gjashtë e kanë përfunduar 3 fëmijë; klasën e tetë e kanë përfunduar 3 fëmijë; klasën e nëntë e kanë përfunduar 2 fëmijë. Siç duket ka një shpërndarje të gjerë të nivelit të shkollimit që

fëmijët kanë pasur para dënimit. Pyetjes se në cilën moshë janë shkëputur nga shkolla i janë përgjigjur të gjithë dhe mosha mesatare e shkëputjes nga shkolla është 12.46 vjeç. Pra në mesatare ata janë shkëputur nga shkolla jo për shkak të dënimit me burgim, pasi mosha e përgjegjësisë penale është 14 vjeç. Vetëm 3 të mitur janë shkëputur nga shkolla për shkak të dënimit penal. E kanë braktisur shkollën para se të dënoheshin 9 të mitur dhe vetëm 1 i mitur kishte përfunduar arsimin 9-vjeçar para dënimit.

Në lidhje me të drejtën e mbrojtjes ligjore, nga personat e intervistuar pranohet se kanë patur mundësinë e zgjedhjes së një mbrojtësi ligjor në momentin e arrestimit dhe këtë e kanë bërë vetë, e kanë siguruar nga familja, ose është i caktuar kryesisht nga shteti. Në diskutimin me grupet e gjyqtarëve për cilësinë e mbrojtjes ligjore, u ngrit si problem që në caktimin e masës së sigurisë, ndodh shpesh që caktohen avokatë të rastësishëm, të cilët gjenden në ambientet e gjykatës, ose afër saj dhe ka shumë raste kur këta nuk i kanë aftësitë e duhura. Ata nuk kanë një trajnim specifik për mbrojtjen e fëmijëve. Kjo kërkon një bashkëpunim më të mirë ndërmjet Dhomës së Avokatisë dhe gjykatës, për të mos ia lënë rastësisë caktimit të një avokati nga shteti, kur kjo është e nevojshme. Cilësia jo e mirë e mbrojtjes ligjore në momentin e caktimit të masës së sigurisë, është një faktor që ka ndikuar në shumë raste në marrjen e një vendimi unanim me kërkesën e prokurorisë. Probleme vërehen gjatë kohës së marrjes në pyetje nga prokurorët ose oficerët e policisë gjyqësore. Të paraburgosurit janë shprehur për mospjesëmarrje të avokatit gjatë seancave të pyetjes, veçanërisht në momentin e arrestimit. Madje janë shprehur se në shumë raste prania e mbrojtësit ligjor ka qenë fiktive, vetëm sa për të nënshkruar dokumentat, dhe më pas nuk kanë patur kontakte me të. Cilësia e punës së avokatëve ka ndikuar edhe në zgjatjen e procedimit penal, si për shembull në rastin e E.K, 17 vjeç, i akuzuar për vrasje dhe i arrestuar në qershor 2007, për të cilin nuk ka përfunduar akoma procedimi penal. Afatet e procedimit penal janë të njëjta si për të miturin edhe për të rriturit. Kjo mendojmë se duhet të korrigjohet duke u udhëhequr nga parimet kryesore të instrumentave ndërkombëtare. Ligji parashikon edhe asistencën psikologjike, por nga monitorimet e organizatave të ndryshme janë konstatuar probleme.

Një hap shumë i rëndësishëm në përmirësimin e drejtësisë për të mitur dhe të drejtësisë në përgjithësi është shënuar me krijimin e shërbimit të provës.⁴ Shërbimi i provës është një institucion shtetëror që mbikqyr zbatimin e dënimeve alternative, paraqet informacion dhe raport në prokurori dhe gjykatë sipas ligjit dhe ndihmon në zbatimin e dënimeve alternative dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin social të të dënuarit. Shërbimi i Provës bashkëpunon me institucione lokale dhe OJQ, për mbështetjen në zbatimin e programeve sociale dhe shërbimin e ndërmjetësimit. Shërbimi i provës

⁴ Miratuar me Ligjin nr 10024, datë 27.11.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr 8331 datë 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NË SHQIPËRI

ndihmon të dënuarit për të kapërcyer vështirsitë për riintegrimin social dhe për të vendosur kontakte me familjen, dhe ambjentin shoqëror të të dënuarit dhe OJQ.

Viti	Numri total i të dënuarve	Të mitur	Të dënuar me burg				Të dënuar me gjobë	Dënime alternative
			Deri 2 vjet	2-5 vjet	5-10	10-25		
2002	4370	274						
2003	6628	308						
2004	6379	320	211	41	15	2	53	
2005	6317	289	239	17	7	0	26	-
2006	6613	268	224	4	9	0	31	-
2007	5678	211	176	8	-	1	26	-
2008	7602	407	342	15	2	2	46	-

Nga viti 2009, me fillimin e shërbimit të provës, kemi një ndryshim në strukturën e dënimeve, ku deri në 50% kanë qenë dënime alternative, si punë në interes publik, dënim me kusht, detyrim paraqitje etj.

7. Konkluzione dhe rekomandime

Si konkluzion mund të themi se nga viti 1990 në Shqipëri janë bërë ndryshime të rëndësishme në përmirësimin e sistemit të drejtësisë penale. Është krijuar një kuadër i plotë ligjor në përputhje me standartet e kërkuara nga instrumentat ndërkombëtare. Janë krijuar seksione të posaçme të gjykatave për të mitur, pranë rretheve gjyqësore, si dhe seksione të prokurorisë dhe sektorë të veçantë pranë komisarivateve të policisë. Janë miratuar strategjitë për mbrojtjen e fëmijëve. Në vitin 2008 dhe 2009 janë hapur pesë institucione të reja për ekzekutimin e dënimeve penale, të cilët kanë seksione të veçanta ku janë akomoduar të mitur, të cilët presin gjykimin. Në vitin 2009 u hap Institucioni i të Miturve në Kavajë, ku janë akomoduar të miturit të cilët kanë marrë dënim të formës së prerë. Ky institucion është ndërtuar me financimin e Komisionit Europian dhe nga ana infrastrukturore i plotëson të gjitha standartet. Një punë e kujdesshme është bërë nga Drejtoria e Burgjeve për përzgjedhjen e stafit dhe trajnimin e tyre. Përmirësime janë bërë në zbatimin korrekt të ligjit procedural, dhe në aplikimin e dënimeve alternative.

Sigurimi dhe trajtimi i të miturve në Institucionet Penale është fokusuar në zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe në përgatitjen e tyre për rikthim në shoqëri si qytetarë të denjë për të marrë përsipër përgjegjësinë e të jetuarit në përputhje me normat e shoqërisë. Për përmirësim të mëtejshme të sistemit të drejtësisë për të mitur do të ndikonin plotësimi i disa rekomandimeve si:

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NË SHQIPËRI

- Krijmi i një kornize ligjore specifike për të miturit në konflikt me ligjin në përputhje me standartet ndërkombëtare.
- Rishikimi në Kodin e Procedurës Penale i afateve të procedimit penal për të miturit, në dritën e standarteve ndërkombëtare.
- Përkthimi zyrtar i të gjitha instrumentave ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Europian dhe dërgimi i tyre zyrtarisht pranë institucioneve që lidhen me sistemin e drejtësisë për të mitur.
- Unifikimi i asistencës ligjore dhe psikologjike për të miturit, gjatë gjithë fazës së procedimit, penal, gjyqimit dhe implementimit.
- Trajnimi i vazhdueshëm i të gjithë aktorëve, gjykatës, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, punonjës të policisë, punonjës të shërbimit të burgjeve dhe paraburgimeve dhe shërbimi i provës në lidhje me standartet ndërkombëtare për trajtimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, aktet ligjore kombëtare dhe veçoritë psiko-sociale të të miturve.
- Rishikimi dhe monitorimi i politikave parandaluese të kriminalitetit tek të rinjtë dhe përmirësimi i bashkëpunimit midis aktorëve të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore.
- Hartimi i mekanizmave parandalues të akteve korruptive të profesionistëve që kanë të bëjnë me drejtësinë për të mitur.
- Përpunimi i të dhënave statistikore si dhe thellimi i studimeve kriminologjike mbi shkaqet dhe parandalimin e kriminalitetit.

BIBLIOGRAFI

Burime arkivore:

AQSH, F. D. V.

AQSH, F. D. V.

Kodi Penal i Mbretërisë Shqiptare viti 1928

Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë bot. 1952, ribotim 1959

Kodi Penal e RPS Shqipërisë bot. 1977.

Akte ligjore:

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë 1995

Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë 1995

Ligji nr 8331, datë 21.04.1998, i ndryshuar “Për ekzekutimin e vendimeve penale”

Ligji nr 8328, datë 16.04.1998, i ndryshuar “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”

Ligji nr 10023 datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar

Ligji nr 10024 datë 27.11.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve Penale”

Ligji nr 10039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”

Ligji nr 9090 datë 26.06.2003 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Vjetari statistikor i Ministrisë së drejtësisë 2004-2008

Konventa për të Drejtat e Fëmijës 1989

Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e fëmijëve të privuar nga liria(Rregullat e Havanës),1990

Rregullat Standart Minimum të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur.(Rregullat e Pekinit),1985

Strategjia Kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve 2005-2010

Strategjia Kombëtare për të rinjtë 2007-2013

A COMPARISON OF THE ALBANIAN JUSTICE SYSTEM FOR MINORS AND JUVENILES WITH INTERNATIONAL STANDARDS

Summary: The Republic of Albania has a population of about 3.320.000 inhabitants, of which 1.306.000 or nearly 40% of the total population is under 18 years old and the average life expectancy is about 72 years. The protection of children's rights is one of the most important social policies in Albania. These policies are based on the fundamental principles of the Constitution of Albania, as well as on UN Conventions and other international instruments ratified by the Albanian Government. Human rights in general and children rights in particular have achieved significant improvements as a result of a comprehensive legal reform and approximation with EU standards. In February 1992, Albania ratified the Convention on the Rights of the Child, as one of the most important instruments of international law in this field. This important convention after ratification has been published and made known to the general public and also to institutions, judicial bodies and organizations in Albania. The state policies for protecting children are based on the adaption of these standards:

- National Strategy for Children and Action Plan 2001-2005;
- National Strategy for Children and Action Plan 2005-2010;
- National Strategy for Youth, 2007-2013;
- National Strategy and Action Plan for the Fight Against Child Trafficking, Child Protection and Trafficking Victims, 2005-2007;
- Report about CRC implementation to the Committee on the Rights of the Child to the UN.

There have been established and are operating near the local government the Child Protection Units, the section of children's rights near the Albanian Ombudsman and also the Inter-Ministerial Committee on Child Protection. The main objectives of the national strategy for children are:

1. The establishment of structures and provision of sufficient financial and human resources to realize the obligations deriving from the Convention on the Rights of the Child and the National Strategy for Children;
2. Providing equal opportunities for all children, regardless of age, gender, ethnicity, disability, birth status, etc.;
3. The continuation of the process that ensures respect for the interests of children, the right to information and freedom of expression and participation in all matters relating to family, school and other institutions;
4. Establishment of a system of institutions and taking the necessary measures to protect children from all forms of violence, exploitation and abuse;

SISTEMI I DREJTËSISË PËR TË MITUR NË SHQIPËRI

5. Provide help for children living in a family environment, and when necessary provision of alternative care with a priority for those families living with social care assistance;
6. Perfecting the legal framework in the field of adoptions through the Albanian Adoption Committee.
7. Improved care to create equal opportunities for disabled children.
8. Improving care and health service for mother and child within the national standards of this service.
9. Construction of a modern education system, ensuring that all children learn in appropriate conditions and complete compulsory education.
10. Reducing the number of children who work and ensuring their protection system.
11. Reduce the number of street children and establishing services that protect and help them.

The data study of children criminality, as a subject of crime, but also as a victim, shows that a considerable number of children are involved in criminal behavior. Statistics of the last ten years shows that 4 - 6% persons involved in crimes were under 18 years old.

	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
Total number of sentenced persons	4370	6628	6379	6317	6713	5678	4857	4587	4700+ 1000 Probation service
Minors	274	308	320	289	268	211	90	89	105+ 150 in Probation service

Criminal sentences are more than 90% and penalties for violation up to 10%. Main sentences given by courts for minors have been fine and imprisonment. In 2007, from 211 cases 16 of them were given a fine, and the others were sent to prison. In recent years as a result of implementing the National Strategy of Children a significant change has happened in the system of juvenile justice, which consists of improving the criminal and procedural legislation on the treatment of juveniles in conflict with the law.

The Constitution of the Republic of Albania provides that any person who is deprived of their freedom has the right to humane treatment and respect for their dignity. According to Albanian law, a juvenile offender is provided with legal and psychological assistance during every stage of processing, the presence of a parent or other responsible persons for

the minor is necessary. During the trial phase for minors under the age of criminal responsibility (18 years old), the court can suspend the sentence and give specific educational measures. The age of criminal responsibility in Albania is 14 years old for crimes and 16 years old for offenses.

The Code of Criminal Procedure defines a set of guarantees for the protection of minors and especially those sentenced with prison sentence such as the right of the minor's legal representative to defend the minor's interests; the right not to publish personal data and photos of the minor; the provision of other alternative measures to imprisonment for the criminal acts. Law No. 8465 (1999) 'On Mediation' states that mediation for conflict resolution can be a measure foreseen for different criminal offense without addressing the proceedings. Law No. 8328 (1998) amended, provides that minors have to be sent in special institutions for minors and not to prisons for adults. These institutions have to fulfill special requirements such as dealing with information of minors, communication and visits, hygienic sanitary conditions, developing educational programs for children including here basic education, and so on. Implementation of alternative sentences, fragmentation of the sentence given by the court and other measures are now in place in the criminal justice system in Albania. Since 2009 the Probation Service has been up and running. Over 1000 persons in conflict with the law are under the supervisions in probation service, 150 of them are children.

Improvements are made also in the prisons' infrastructure and accommodation conditions. During 2009 is opened a modern center for the treatment of minors in Kavaja, with a capacity of 40 minors and a space of 14,939 m². The center is designed according to the requirements and standards foreseen in the legislation. There are residential premises of 7 m² for each child, sport fields, libraries, classrooms, spaces for activities, hygienic sanitation facilities, and many workshop spaces. The total investment of this prison is 2 million euros. There are established special sections for minors and juveniles in courts and prosecution offices in different districts with the Presidential decree No. 5351 (2007). Since 2007 the entire pre-trial system is under the management and responsibility of the Ministry of Justice. During 2008 five new institutions have been opened that have also special sections for minors in custody.

The biggest change that has occurred in the prison system is changing the philosophy of treatment of persons in conflict with the law, which now relies on fundamental human rights and liberties. The detention and prison system in Albania has as mission to contribute to a safer society through the effective implementation of penalties of imprisonment and other criminal measures, offering people who have been entrusted to the care of this service, the opportunity to build a lifestyle and social return accepted in society. Keywords of the mission of the prison system are security, reintegration and

humane treatment. Special attention is paid to the training of employees who work in institutions for juveniles. Staff working with children is undertaking specific trainings about international conventions for children's rights, national legislation, social and psychological of minors, techniques for conflict resolution and anger management enabling children to demonstrate positive behavior, treatment programs, prevention of transmitted diseases, etc.

Recommendations:

- Preparation of a unified law for juveniles in accordance with the Children Rights Convention, the UN Guidelines for the prevention of youth criminality, (Ryad Guidelines), Standard Minimum Rules of the United Nations for Justice for Minors, (Beijing Rules), and the United Nations Rules for the protection of children who have been deprived from freedom, (Havana Rules).
- Use of other sanctions for minors, where appropriate, in order to avoid sending minors in prisons – taking into consideration the best interest of the child.
- The establishment of social welfare institutions for minors under 14 years old who have committed criminal offenses.
- Training of judges, prosecutors and staff who are responsible for dealing with minors.
- Application of a national program for the reintegration of juveniles in conflict with the law after the period of release.